

TË DHËNAT PËR ASETIN
Shitja e Aseteve përmes Likuidimit Nr.72
Njësia e Vendosur në Tender Nr.19
KB Burimi-Parcela nr.177-2 dhe 177-3 ZK Baicë

Emri i NSh.-së	"KB Burimi Vrellë ", Istog, në likuidim (në likuidim) Fi: 167/91; Fi:147/85
Lloji i Shitjes	Shitje përmes Likuidimit me ofertë të mbyllur.
Dita e Ofertimit	Më 28.05.2025 nga ora 10:00h deri 12:00h në Sallën e Konferencave të "HOTEL GRAND" në Prishtinë.
Çmimi Minimal	1,800 €/ari
Depozita e Ofertës	€ 7,000
Kategoria potenciale për shfrytëzim	Rezidenciale

Përshkrimi i Aseteve

Vendndodhja e Aseteve	<p>Zona Kadastrale Baicë, Komuna e Istogut.</p> <p>Të dhënat e hartës ©2024 Google</p> <p>Rr. 8 Maji, Baicë-Komuna e Istog</p> <p>Shikoni këtë pronë në Google Maps</p> <p>Aktmohim: Vendndodhjet e treguara nga PIN-at në Google Maps ofrohen vetëm për qëllime të orientimit dhe referencës së përgjithshme. Këto mund të mos pasqyrojnë saktësisht vendndodhjen, kufijtë ose veçori të tjera të asetëve të përshkruara. Përdoruesit këshillohen të verifikojnë në mënyrë të pavarur të gjitha vendndodhjet për çdo çështje që kërkon saktësi ose informacion me rëndësi ligjore.</p>
Ndërtesat dhe tokat	<p>Kjo shitje ofron tokën me sipërfaqe 7756m² (77ari dhe 56m²) e cila shtrihet në ZK Baicë, Komuna Istog dhe përfshinë parcelat e përshkruara si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none">- Parcelën nr.00177-2 me sipërfaqe 948m², me kulturë livadh i klasës 4- Parcelën nr.00177-3 me sipërfaqe prej 6808m² me kulturë arë e klasës 4. <p>Prona ka qasje në rrugë publike nr.164, ka devijim të rrugës publike dhe trotuarit në sipërfaqe prej 78m², në pjesën veriore të parceles nr.177-3.</p>
Shfrytëzuesit	<p>Nuk ka ndërtesë në këtë shitje.</p> <p>Nuk ekziston ndonjë marrëveshje për shfrytëzim të këtyre parcelave. Nga vizita në teren vërehet se toka ka qenë e punuar.</p>
Asetet tjera	Nuk ka.
Detyrimet që do të barten	Asnjë nga detyrimet nuk do të barten tek blerësi i ri, por sidoqoftë blerësi potencial duhet të ketë parasysh se mund të jetë i aplikueshëm tatimi për bartjen e pronës.

Foto/fotot
ose informata të tjera
për asetet ne shitje.



Informatat rreth Njësisë lëndë e shitjes të prezantuar në Te Dhëna nuk janë të garantuara. Investitorët potencial inkurajohen të kontaktojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) për të kërkuar dokumentet e tenderit. Ata të cilët dëshirojnë të paraqesin ofertë duhet të llogarisin në hulumtimet e tyre. Investitorët potencial këshillohen të bëjnë verifikimin e të dhënave vet para se të paraqesin ndonjë ofertë ose propozim për tender. Këto të Dhëna janë në dispozicion nën kushtet e përgjithshme në informatat paraprake për informacione të publikut të gjerë për kandidatët e privatizimit, e cila mund të nxirret nga faqja e internetit të AKP-së: www.pak-ks.org.



RAPORT I VIZITËS NË TERREN

KB BURIMI

Parcelat nr.177-2 dhe 177-3 z.k Baicë, Istog

Me datë 03.02.2025 zyrtarët e AKP-së vizituan pronën e KB Burimi, konkretisht parcelën me nr.177-2 dhe 177-3 z.k Baicë, Komuna e Istogut.

Sipërfaqja e përbashkët parcelave të lartëcekura sipas certifikatës së pronësisë është 7756m² (77 ari dhe 56 m²) prej të cilave :

Parcela nr.177-2 me sip.948 m² me kulturë : bujqësore, livadh i klasës 4;

Parcela nr.177-3 me sip.6808 m² me kulturë : bujqësore, anë e klasës 4;

Parcela nr.	Z.K	Komuna	Sip.në certifikatë	Sip. grafike	Dallimi m ²
177-2	Baicë	Istog	948	910	-38
177-3	Baicë	Istog	6808	6844	+36



Ortofoto e parcelave nr.177-2 dhe 177-3 z.k Baicë, Istog

Nga vizita jonë në terren konstatuam se :

1. Siç shihet edhe në ortofoto parcelat kanë qasje në rrugën publike me nr.164;
2. Toka ka qenë e punuar më herët;
3. Toka nuk ishte e rrethuar.
4. Në terren kemi devijim të rrugës publike dhe trotuarit me c'rast sipërfaqja prej 78 m² (trotuar dhe rrugë) hyn në pjesën veriore të parcelës nr.177-3 .



Fotografia e mëposhtme prezanton gjendjen faktike në terren :



Pamje e parcelës nr.177-2 dhe 177-3 z.k.Baicë, Komuna e Istogut

D.G-Zyrtar Kadastral Rajonal

M.C.M- Zyrtare e Operacioneve për Administrim të Aseteve

AKP- ZR PEJË/SHKURT 2025

**Informatat dhe
Dokumenmtet e
Ofertimit**

Divizioni i Marketingut dhe Tenderit Publik

Tel: +383 (0) 38 500 400 lok.1090, 2059

www.pak-ks.org

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Rruga: Dritan Hoxha, nr.55

10000 Prishtinë, Republika e Kosovës